



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. _____ /2015

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 69/2012, “PËR SISTEMIN
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pikat 8, 10, 12 dhe 19, të nenit 2, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. “Kurrikula”, sistem i përbërë nga disa elemente me synime arsimore që, të lidhura mes tyre, lejojnë të orientohej dhe të funksionojë sistemi arsimor, nëpërmjet planeve arsimore dhe administrative. Kurrikula siguron arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

...

10 “Kompetenca themelore”, kompetenca për të cilat kanë nevojë të gjithë individët për plotësim dhe zhvillim vetjak, për qytetari aktive, për përfshirje sociale dhe për punësim.

- ...
- 12 “Kurrikula bërthamë”, kurrikul e përbashkët për të gjithë nxënësit e një niveli në sistemin arsimor.
- ...
19. “Program mësimor”, dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënës, metodologjitë e të nxënës dhe të vlerësimit për një lëndë të caktuar.”.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Qëllimi i sistemit arsimor parauniversitar

1. Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënës të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.
2. Në arsimin parauniversitar nxënës:
 - a) kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
 - b) përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
 - c) zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
 - ç) zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
 - d) aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
 - dh) aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
 - e) zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
 - ë) përdorin teknologjitë e reja.”.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Kompetencat themelore

Kompetencat themelore për të gjithë nxënësit janë:

- a) Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- b) Kompetenca e të menduarit;
- c) Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
- ç) Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- d) Kompetenca personale;
- dh) Kompetenca qytetare;
- e) Kompetenca digjitale.”.

Neni 4

Pika 2, e nenit 22, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Arsimi bazë përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët. Arsimi fillor përbëhet nga pesë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Arsimi i mesëm i ulët përbëhet nga katër klasa, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë.”.

Neni 5

Në nenin 45, pika 2, shkronja “c”, fjalët “... standardet e të nxënës ...” zëvendësohen me “... kurrikul bërthamë ...”.

Neni 6

Në nenin 47 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Tekstet shkollore përzgjidhen mbi bazën e standardeve të teksteve nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të barabartë dhe transparent. Procedurat e zhvillimit të konkursit përcaktohen me udhëzim të ministrit. Përjashtimet nga ky rregull përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Tekstet për nxënësit janë unike për çdo lëndë ose fushë të të nxënës, sipas klasave dhe për të gjitha shkollat. Ato sigurohen nga botuesit vendas ose të huaj. Tekstet certifikohen nga ministria.”.

2. Pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 7

Pika 1, e nenit 53, ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “1. Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet “Medalje e Artë” nga Kryeministri, me propozimin e ministrit.”.

Neni 8

Në nenin 60 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “1. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ILIR META